ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Numri i prokurimit	**214-24-9937-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së - ri tender 2

Ri-Vlerësim pas Vendimit - OSHP: 2024/1208 i datës 13.02.2025

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Emri i Kompanisë: "Beni Dona Plast: SH.P.K

Adresa : Lagja Ulpiana, Rruga Imzot Nikë Prelaj , Prishtine

Numri Telefonit: 044/508 507

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: Fadil Paçarada

Adresa elektronike: ***prokurimi.zyra@gmail.com***

Data e parashtrimit të ankesës: 04.04.2025

Nënshkrimi dhe vula:_____

BENI DONA - PLAST

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

*(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)*_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. B05- Njoftimi për kontrate: 27.09.2024
2. Afati për dorëzim të tenderit: 15.10.2024
3. Kriteret e dhënies: Çmimi më i ulët
4. Aneksi 5- Kërkesë për Informacione shtese Beni Dona Plast SH.P.K: 08.10.2024
5. Procesverbali i Hapjes se Ofertave: 15.10.2024
6. Letra Standarde e Kërkesë për informata mbi tenderët me çmimeve jo normalisht të ulëta:19.11.2024
7. Përgjigjja në kërkesën e AK për çmime jo normalisht të ulëta ,Beni Dona Plast SH.P.K: 20.11.2024
8. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Anulim i aktivitetit të prokurimit: 26.03.2024
9. Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar: 27.11.2024 ora 15:37
10. Kërkese për mes Platformës së E-Prokurimit për qasje në dokumentet e tenderit: 29.11.2024 ora 10:22
11. Kërkese për mes emailit zyrtare për qasje në dokumentet e tenderit: 29.11.2024 ora 10:27
12. Konfirmim i AK për mese emalit zyrtare për lejimin e qasjes në Dokumentet e Tenderit me datën 02.12.2024 prej orës 11:00 deri 12:00 qasje: 29.11.2029 ora 14:37
13. Përsëritje e Kërkesës për mese emalit zyrtar për qasje – dërgimin e dokumenteve të nderit:29.11.2024 ora 15:18
14. Kërkese për Rishqyrtim: 02.12.2024
15. Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 05.12.2024
16. Ankesa nr. 1208/24, dërguar në OSHP me datën 13.12.2024
17. Vendimi i OSHP-së - OSHP: 2024/1208 i datës 13.02.2025
18. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Dhënie e kontratës, OE " Isuf Musliu" BI ne vlere prej 1,371,644.00 € : 19.03.2025
19. Kërkese për Rishqyrtim: 24.03.2025
20. Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 27.03.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					**Jo**	X	

Hapja e ofertave është bere me datën 15.10.2024 në ora 14:00

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X				**Jo**		

Autoriteti Kontraktues - Akademia e Kosovës për Siguri Publike, me datën **19.03.2025** në platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe prapë ka shpërblyer me kontratë **OE: "Isuf Musliu" BI** nga Vushtrria në vlere totale prej: **1,371,644.00 €** dhe Letrat Standarde për Tenderuesin e Eliminuar te kompanisë tone Beni Dona Plast SH.P.K.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po X **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën 24.03.2025 përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – Akademia e Kosovës për Siguri Publike. Me datën 27.03.2025 përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesën ton për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 1- Qëllimi;
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Shkeljet e dispozitave - Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, janë:
Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 97 - Shkeljet e rënda - Mos Zbatimi i vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit 2024/1208 i datës 13.02.2025

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pas Ri-vlerësimit të ofertave pas **vendimit - OSHP: 2024/1208 të datës 13.02.2025** - Autoriteti Kontraktues – Akademia e Kosovës për Siguri Publike, me datën **19.03.2025 në ora 14:52** në platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ku me kontrate prape e ka shpërblyer OE "Isuf Musliu" BI nga Vushtrria në vlere totale prej: **1,371,644.00 €.**

Me datën **20.03.2025** në ora **10:45** përmes Platformës së E-prokurimit kemi bere kërkese për qasje në dokumente e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues- Zyrtari e Përgjegjës i Prokurimit (ZPP) me datën **20.03.2025** ne ora **13.30** na përmes platformës së E-Prokurimit na informon se ne qasje mend te vini m datën **21.03.2025** nga ora **10:00 deri 11:00** mundtë shkojmë në qasje të dokumenteve te tenderit.

Me datën **21.03.2025** kemi qene ne qasje dhe Zyrtari Përgjues i Prokurimit na ka lejuar vetëm qasje të kufizuar në dokumentet e tenderit me arsyetimin së OE "Isuf Musliu" BI së bashku me ofertën ka dorëzuar Aneksin 3 – Kërkese për Sekret Afarist.

Me datën **24.03.2025** përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – Akademia e Kosovës për Siguri Publike. Me datën **27.03.2025** përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesën ton për rishqyrtim.

Edhe ketë here Përgjigjja – Vendimi i Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesën ton për rishqyrtim nuk është e nënshkruar nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit (z. Bekim Dakaj) e as nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm te AKSP-së, (z. Kastriot Jashari).
Bazuar në shkeljet që kane bere AK gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit , konsiderojmë së mos nënshkrimi e këtij vendimi dhe vendimit paraprak nga këta dy zyrtar të AK - AKSP-së, dy here radhazi është i qëllimshëm dhe tentim për tu shmangur nga marrja e përgjegjësi për shkeljet substanciale që kane bere gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Deri sa herëve tjera arsyejet të cilat AK- AKSP i shënonte, në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar dhe Vendimet për refuzim të Kërkesave tona për Rishqyrtim për ketë aktivitet të prokurimit ishin shume të gjata, duke tentuar çdo here që ti arsyetojnë shkeljet e bëra gjate zhvillimit të aktivitetit të prokurimit, tani edhe në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës **19.03.2025** dhe Vendimin e datës **27.03.2025** për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim të datës **24.03.2025** ka shënuar vetëm nga një fjali:

Ne Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar **te datës 19.03.2025 ka shënuar së në Dosjen e Tenderit për artikullin Gullash gjedhi-pako 4- është kërkuar 3 vite garancion , ndërsa OE Beni Dona ka ofertuar 2 vite garancion.**

Kjo nuk qëndron për faktin së në Dosjen e Tenderit është kërkuar që artikujt të kenë afat përdorimi të mjaftueshëm dhe në veçanti tek ushqimi i paketuar me numër 3, 4, 5 dhe 6 afati i ushqimit duhet të **jetë minimumi 36 muaj** (jo fiks 3 vite ashtu siç e ka shënuar AK në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar te datës **19.03.2025) dhe së artikulli Gullash gjedhi-pako 4- me te cilin kemi ofertuar, afatin e ka deri ne 10 vite e jo 2 vite ashtu siç ka shënuar AK në** Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës **19.03.2025 . Ketë e ka konfirmuar vete kompania Prodhuese dhe gjithashtu ketë informate mund ta gjeje çdo pale e interesuar në web faqen e kompanisë prodhuese EXPRES MENU s.r.o.** (**www.expresmenu.com**).

Në Vendimin e datës **27.03.2025** për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim të datës **24.03.2025** ka shënuar **Arsyetimi:**
"Në bazë të kërkesës për rishqyrtim të datës 24.03.2025 kërkesa e juaja refuzohet pasi që nuk keni ofruar fakte dhe dëshmi mbi arsyet e eliminimit të ofertës tuaj".

Në konsiderojmë së Zyrtaret Përgjegjës të AK të ballafaquar me fakte dhe argumente që kemi shënuar në Kërkesën tone për Rishqyrtim të datës **24.03.2025**, kane vendose që **të mos i trajtojnë asnjërin nga pretendimet tona ankimore** por vetëm kane shënuar një fjali sa për të **plotësuar anën formale** të kthimit të përgjigjes -Vendimit për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim.

Pretendimi ankimor 1- shkelje e nenit 1,6 dhe 46 të LPP

Autoriteti Kontraktues - Akademia e Kosovës për Siguri Publike, aktivitetin e pare me numër të prokurimit:**214-23-29-211- Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së**, e ka filluar me publikimin e Njoftimit për Kontrate ne Platformën e prokurimit me datën **11.01.2023**. Për shkak së për **dhjete muaj nuk arritën** që me kontrate ta shpërblej **OE: "Isuf Musliu" B.I** nga Vushtrria, **të preferuar nga Zyrtaret** Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues dhe të cilit ja kishin përshtatur Kriteret e Përzgjedhjes, me datën **17.10.2023** në Platformën e E-Prokurimit publikuan Formularin B10- Njoftim për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit.

Autoriteti Kontraktues - Akademia e Kosovës për Siguri Publike prape me datën **24.11.2023** në Platformën e prokurimit publikoi Njoftimin për Kontrate për aktivitetin me numër të prokurimit **214-23-13065-211- Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së - Ri tender.** Prape Zyrtaret e AK- vazhduan me diskriminimin e OE tjerë dhe me favorizimin e **OE: "Isuf Musliu" B.I** duke ja përshtatur Kriteret e Përzgjedhjes duke kërkuar **Autorizim nga prodhuesi ose Dileri i autorizuar për shitje për ushqimin e paketuar me nr. 3,4,5,6 dhe duke Ndryshuar Përshkrimin e Çmimeve** duke i shtuar katër artikuj të cilët AK asnjëherë për mbi **20 vite** nuk i pasur në Përshkrimin e Çmimeve.
Për shkak së prape për **dhjete muaj nuk arritën** që me kontrate ta shpërblej **OE: "Isuf Musliu" B.I** nga Vushtrria, **të preferuar nga Zyrtaret** përgjegjës të Autoritetit Kontraktues dhe të cilit edhe në këtë aktivitet ja kishin përshtatur Kriteret e Përzgjedhjes, me datën **19.08.2024** në Platformën e E-Prokurimit publikuan Formularin **B10- Njoftim për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit**.

Autoriteti Kontraktues - Akademia e Kosovës për Siguri Publike me datën **27.09.2024** në Platformën e prokurimit publikoi Njoftimin për Kontrate për aktivitetin me numër të prokurimit **214-24-9937-211- Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së -Ri tender 2.** Prape Zyrtaret e AK- vazhduan me diskriminimin e OE tjerë dhe me favorizimin e OE: **"Isuf Musliu" B.I** duke ja përshtatur Kriteret e Përzgjedhjes duke kërkuar **Autorizim nga prodhuesi ose Dileri i autorizuar për shitje për ushqimin e paketuar me nr. 3,4,5,6 dhe duke Ndryshuar përbërjen e artikullit 3- të ushqimeve të paketuara**.

Ofertat për këtë aktivitet të prokurimit janë hapur me datën **15.10.2024 ka kane ofertuar vetëm** OE: **"Isuf Musliu" B.I** me çmimin total të ofertës prej: **1,371,644.00 €** dhe kompania e jone **OE: Beni Dona Plast SH.P.K** me çmimin total të ofertës prej:**1,319,152.70 €.**

Prej datës së hapjes së ofertave**15.10.2024** deri me datën **27.11.2024** kane kaluar **43 dite** kur AK në Platformën e E- Prokurimit ka bere publikimit e Formularit B58- **Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpërblim me kontratë OE: "Isuf Musliu" B.I** nga Vushtrria në vlere totale prej: **1,371,644.00€ €.** Duhet theksuar së AK këtë aktivitet të prokurimit e ka zhvilluar duke përdoruar afatet e shkurtuara kohore nga **40 dite** sa janë afatet normale ligjore në **20 dite**, me arsyetim e urgjencës që kane për këto shërbime, ndërsa për vlerësimin e ofertave ju kane dashur **43 dite.**

Pasi Autoriteti Kontraktues me datën **27.11.2024** në ora **15:37** në platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpërblim me kontratë OE: "Isuf Musliu" BI nga Vushtrria në vlere totale prej: **1,371,644.00 €** që është për **52,491.30 €** me **e larte së çmimi** total i ofertës tone – OE; Beni Dona Plast SH.P.K. dhe po me këtë date përmes Platformës së E-Prokurimit na dërgon Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar.

Kompania jone me datën **02.12.2024** përmes Platformës së E-Prokurimit ka dërguar të AK Kërkesën për Rishqyrtim.
Autoriteti Kontraktues - Akademia e Kosovës për Siguri Publike, me datën **05.12.2024** përmes Platformës së E-Prokurimit na ka dërguar Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim.
Kjo Përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesën ton për rishqyrtim e datës **05.12.2024** nuk ishte e nënshkruar nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit (Bekim Dakaj) e as nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm te AKSP-së, (z. Kastriot Jashari).
Bazuar në shkeljet që kane bere AK gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit , konsiderojmë së ky veprim i këtyre dy zyrtareve të AK - AKSP-së, është i qëllimshëm dhe tentim për tu shmangur nga marrja e përgjegjësi për shkeljet substanciale që kane bere gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit duke përfshi edhe hartimin e Përgjigjes – Vendimin për refuzim të Kërkesës tone për Rishqyrtim.
Gjithashtu edhe arsyejet të cilat Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK- AKSP i ka shënuar, në Përgjigjen e datës **05.12.2024** , për refuzim të Kërkesën tone për Rishqyrtim, ishin të pa qëndrueshme, manipuluese dhe në kundërshtim të plote me dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të cekura me larte.
Më datën **13.12.2024** kompania jone Beni Dona Plast SH.P.K ka dërguar në Organin Shqyrtues të Prokurimit ankesën nr. **1208/24.**
Paneli Shqyrtues i OSHP-së me datën **13.02.2025** ka nxjerre vendimin nr. **OSHP: 2024/1208** , ku aneksen tone e pranon si pjesërisht të bazuar dhe lenden e kthen ne **Ri-Vlerësim.**
Si rezultat e këtyre veprimeve të cekura me lartë, Zyrtaret e AK- AKSP, mbi dy vite nuk po arrijnë që me sukses ta përfundojnë ketë aktivitet të prokurimit por vazhdojnë që me kontrate ta shpërbleje të njëjtin OE: "Isuf Musliu" B.I duke përdore Proceduarën e Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontratë.
Vetëm për periudhën kohore **Maj 2023 - Shtator 2024**, duke përdore Proceduarën e Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontratë dhe pa na ftuar asnjë here në negociata edhe pse kompania jone Beni Dona Plast SH.P.K është lider në Republikën e Kosovës sa i përket kryerjes së këtyre shërbimeve dhe pa ftuar asnjë OE tjetër në negociata, ka ftuar, negociuar dhe ka nënshkruar kontrata vetëm me OE të preferuar- **OE: "Isuf Musliu" BI** nga Vushtrria, në vlere prej **1,591,642.70 Euro.**

Zyrtaret Përgjegjës të AK- AKSP, edhe pas vendimit të OSHP-se, nr. **OSHP: 2024/1208** të datës **13.02.2025** , prape vazhduan me neglizhence dhe zvarritjen e procesit të vlerësimit të ofertave ku prej datës **13.02.2025** ju deshën **35 ditë** për ta përfunduar Ri-vlerësimin e ofertave.

Së kjo zvarritje është e qëllimshme e dëshmon fakti së Autoriteti Kontraktues - Akademia e Kosovës për Siguri Publike prape duke përdore Proceduarën e Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontratë ka zhvilluar aktivitetin me numër të prokurimit **214-25-1102-2-1-5 - Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së** dhe me datën **18.03.2025 (një dite para publikimit të Formularit B58 për procedurën e hapur)** në Platformën e E-Prokurimit ka publikuar Formularin B08- Njoftim për Dhënie të Kontratës ku me kontrate ka shpërblyer operatorin e preferuar nga AK - OE: "Isuf Musliu" B.I ne vlere **447,145.00** për gjashte muajt e ardhshëm.

Të gjitha këto që i cekem me larte dëshmojnë së **Zyrtaret Përgjegjës të AK**- Akademia e Kosovës për Siguri Publike gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit kane **bere shkelje substanciale të nenit 1 të LPP që është qëllimi i ligjit, nenit 6 të LPP- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti dhe neni 46 të LPP - Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore për faktin së nuk kane arritur:**

- Të sigurojnë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të buxhetit të AK;

- Të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve të AK;
- Të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës;
- Të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale të paanshme dhe etike;
- Të ndjekin parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike;
- Të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit;
- Të parandaloj keqpërdorimin e shkurtimit të afatit kohor duke dhëne arsyetime të pa bazuara për faktin së Emergjenca është shkaktuar nga neglizhenca e vete Zyrtarëve Përgjegjës të AK, ku ketë me së miri e dëshmon fakti që për 43 dite e nuk i vlerësuan ofertat.

Pretendimi ankimor 2 - shkelje e nenit 7 të LPP

Bazuar në ofertën tone dhe arsyet e eliminimit të cilat AK i ka shënuar në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës **19.03.2025**, shume kjarte shihet së AK gjate Ri- vlerësimit të ofertave ka bere shkelje substanciale të **nenit 7 të LPP** për faktin së kompania jone , OE: Beni Dona Plast SH.P.K dhe OE: "Isuf Musliu" B.I, kemi ofertuar me produkte të paketuara **3,4,5,6**, që prodhohen nga i njëjti prodhues - **EXPRESS MENU s.r.o nga Çekia** dhe të **Autorizuar** po nga ky prodhues dhe AK prape gjate Ri-vlerësimit të ofertave na ka diskriminuar duke na eliminuar nga aktiviteti i prokurimit dhe favorizuar OE: "Isuf Musliu" B.I, duke e shpërblyer me kontrate edhe pse oferta e këtij OE është për **52,491,30 €** me **e larte së çmimi** total i ofertës tone.

Së Autoriteti Kontraktues: AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURINË PUBLIKE nuk na ka trajtuar të barabarte gjate vlerësimit të ofertave e ka konstatuar edhe Paneli Shqyrtues në Vendimin nr. **OSHP: 2024/1208** të datës **13.02.2025**, ku ka konstatuar:

"Se gjatë këtij vlerësimi të këtij aktiviteti janë përdorur standarde të dyfishta për të cilat PSH konsideron se janë në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit publik, rrjedhimisht konstaton së pretendimi ankimor është i bazuar".

Pretendimi ankimor 3 - shkelje e nenit 59 dhe 72 të LPP si dhe nenit 40 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik

Pretendimi i AK së gjeja artikulli i paketuar nr.4- Gullash gjedhi nuk i plotëson specifikat teknike, dhe së nuk e ka afatin 3 vite ashtu siç është kërkuar, nuk qëndron, për faktin së Katalogët të cilëve ju ka referuar AK, janë katalogë gjeneralë për prodhimin e artikujve të paketuar aktual që **EXPRESS MENU s.r.o nga Çekia ka pranuar porositë.**

Në këta katalogë shënon edhe **data** së kur artikujt e paketuar janë gati të prodhuar dhe të gatshëm për treg. Ketë e dëshmon edhe katalogu që AK ju ka referuar për artikullin nr.4 Gullash gjedhi ku shënon: **"Mallrat mund të merren me datën 27 nëntor 2024"**. Gjithashtu në katalogun që i referohet AK shënon: **Afati minimal 2 vite** e jo ashtu siç pretendon AK se afati **është 2 vite**.

Kompania prodhuese **EXPRESS MENU s.r.o nga Çekia** ka kapacitete për ti prodhuar të gjitha llojet e artikujve të paketuar sipas specifikave teknike dhe afateve të përdorimit sipas kërkesave të porositësit të artikujve duke përfshi edhe artikujt e paketuar **3,4,5,6** që AK i ka kërkuar në Dosjen e Tenderit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Afati i përdorimit të artikujve të paketuar të prodhuar nga kompania prodhuese **EXPRESS MENU s.r.o** , varet nga ambalazhi që paketohen. Varësisht së cilin afat të përdorimit të artikujve të paketuar e kërkojnë klientët e kësaj kompanie, kjo e zgjedhë edhe ambalazhimin që i përshtatet atij afati të përdorimit.

Gjithashtu edhe përbërja e artikujve të paketuar, varet nga kërkesat e klientëve dhe specifikat teknike që klienti i kërkon.

Katalogët e artikujve ushqimor të paketuar të publikuar ne web faqen e **EXPRESS MENU s.r.o nga Çekia,** nuk mund të trajtohen sikurse me qene **katalogë të automjeteve, pajisje të IT apo pajisje tjera teknike që janë të pandryshuar për vite të tera.**

Kompania EXPRESS MENU s.r.o nga Çekia, Katalogët e artikujve ushqimor të paketuar, i ndryshon dhe i publikon në web faqen e saj sa here që ndonjërin nga artikuj i ka ndryshuar specifikat teknikë sipas kërkesave të klientëve të saj ashtu siç e cekem me larte.

Kompania jone Beni Dona Plast SH.P.K së bashku me ofertën ka dërguar të AK edhe **Autorizimin e kompanisë Prodhuese EXPRESS MENU s.r.o nga Çekia dhe një Konfirmim të kësaj kompanie** që kompania prodhuese EXPRESS MENU s.r.o. konfirmon së aktualisht po prodhojmë Pashteten e pulës 120gr. me këtë përbërje: mëlçia e gjelit të detit (20 %), mish pule (20 %), perime me rrënjë (karrota, selino, majdanoz), ujë, qepë, bajame (5 %), boronicë (3 %) (boronicë, sheqer, vaj luledielli , hudhra, kripe, gjethe dafine, piper i plote, piper i kuq.

Për ushqimin e paketuar 3- artikulli nr. 2- - Pashtete 120 gr. e kërkuar në tenderin me numër te prokurimit 214-24-9937-211- Shërbime për përgatitje dhe furnizim ushqimi për nevojat e AKSP – Ri Tender 2, i publikuar nga Autoriteti Kontraktues: AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURINË PUBLIKE, kompania jonë prodhuese EXPRES MENU s.r.o. i ka të gjitha kapacitetet për të prodhuar Pashteten 120 gr, të përbërë nga: Min. mish pule (40%), perime, karota, selino, majdanoz, ujë, qepë min. (5%), hudhra, kripë, gjethe dafine min. me te njëjtën cilësi, kushte përdorimi dhe ambalazhimi si Pashtatet e pulës 120 gr.

Edhe ky Letër konfirmim dëshmon së kompania prodhuese **EXPRESS MENU s.r.o nga Çekia** ka kapacitetet që të prodhoj të gjithë artikujt e paketuar me specifika - përbërje të artikujve, paketim dhe afat të përdorimit sipas porosive të klientëve të vete e në rastin konkret edhe sipas porosisë së kompanisë tone Beni Dona Plast SH.P.K. në rast të nënshkrimit të kontratës me AK- AKSP.

Nëse komisioni i vlerësimit të ofertave apo Zyrtaret Përgjegjës të AK kane pasur pa qartësi lidhur me këta artikuj të paketuar, konforme **nenit 59 paragrafi 2** dhe **nenit 72** të LPP kane pasur mundësi që direkt ti drejtohen me shkrim kompanisë prodhuese EXPRESS MENU s.r.o. nga Çekia për sqarime shtese lidhur me të katër artikujt e paketuar që AK – AKSP-ja ka kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe Përshkrimin e Çmimeve e jo të na diskriminoj duke na eliminuar nga aktiviteti i

prokurimit dhe duke e shpërblyer me kontrate OE: "Isuf Musliu" B.I i cili çmimin total të ofertës e ka për **52,491.30 €** me **e larte së çmimi** total i ofertës tone.

Pasi që Zyrtaret Përgjegjës të AK **gjate Ri vlerësimit të ofertave e as gjate e shqyrtimit** të Kërkesës tone për Rishqyrtim të datës **24.03.2025 nuk vepruan** sipas Vendimit të Panelit Shqyrtues: nr. **OSHP: 2024/1208** të datës **13.02.2025 për të vepruar sipas nenit 59 paragrafi 2** dhe **nenit 72 të LPP,** për të kërkuar sqarime shtese qofte nga kompania jone Beni Dona Plast SHPK apo direkt ti drejtoheshin me shkrim kompanisë prodhuese EXPRESS MENU s.r.o. nga Çekia për sqarime shtese lidhur me të artikujt e paketuar, ne me datën **01.04.2025** kemi dërguar të kompania prodhuese EXPRESS MENU s.r.o. nga Çekia një kërkese për sqarime- konfirmim lidhur me artikullin e paketuar nr. 4- **Gullash me mish viçi dhe patate, min. 330 g** . Ne ketë kërkese përveç tjerash kemi shënuar:

"Meqë **AKSP nuk ka kërkuar ndonjë sqarim shtesë nga kompania juaj**, ju lutemi të konfirmoni nëse kompania juaj prodhuese, **EXPRES MENU s.r.o.**, ka kapacitetin për të prodhuar, paketuar dhe plotësuar kërkesat për jetëgjatësinë e produktit sipas kërkesave të **AKSP për artikullin nr. 4 - Gullash me mish viçi dhe patate, min. 330g,** me **paketim shumë-shtresor të mbyllur me film mbrojtës sipas standardeve**, që përmban copa mishi (**min. 33%**), patate të skuqura, qepë, speca, borzilok, hudhër, vaj dhe piper". (**Dëshmi – Kërkesa për konfirmim që kemi dërguar të kompania Prodhuese EXPRES MENU s.r.o." e datës 01.04.2025).**

Kompania prodhuese "**EXPRES MENU s.r.o.**" **menjëherë me datën 02.04.2025 na dërgon konfirmimin lidhur me kërkesën tone të datës 01.04.2025.**

Në ketë konfirmim, kompania Prodhuese "EXPRES MENU s.r.o", përveç tjerash ka shënuar:

"Bazuar në kërkesën tuaj për sqarim, konfirmojmë së kompania jonë, **EXPRES MENU s.r.o.**, ka kapacitetin për të prodhuar, paketuar dhe ruajtur artikullin e paketuar **Nr. 4 – Gullash me mish viçi dhe patate, min. 330g**, të paketuar në qese **shumë-shtresore të mbyllura me film mbrojtës sipas standardeve**. Ky produkt përmban **copëza mishi (min. 33%)**, patate, qepë, speca, borzilok, hudhër, vaj dhe piper të bluar, ashti siç është kërkuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) – Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP).**

Ne gjithashtu konfirmojmë se jetëgjatësia e këtij produkti është e garantuar falë teknologjisë sonë të patentuar **CTP (Continuous Thermal Process)**, e cila siguron që ushqimi të mbetet pa **konservues, ngjyrues dhe aromatizues**, duke u ruajtur në temperaturë ambienti deri në **10 vite**. Ky informacion është publik dhe mund të verifikohet në faqen tonë zyrtare (**www.expresmenu.com**).

Gjithashtu konfirmojmë së të gjitha produktet e paketuar të kërkuara nga **AKSP (Nr. 3, 4, 5, 6)** prodhohen në përputhje me **specifikimet teknike** të kërkuara nga AK në këtë proces të prokurimit." (**Dëshmi – Konfirmim nga kompania Prodhuese EXPRES MENU s.r.o." nga Çekia e datës 02.04.2025).**

Pretendimi ankimor sa i përket ofertës se OE: "Isuf Musliu" B.I që AK ka shpërblyer me kontrate:

Ne konsiderojmë së oferta e OE: "Isuf Musliu" B.I që AK ka shpërblyer me kontrate është oferte e pa përgjegjshme për këto arsye:

- OE: "Isuf Musliu" B.I ka ofertuar me Autorizim të lëshuar në Dhjetor të vitit 2023 dhe bazuar në sqarimet që ka dhëne AK gjate fazës së para tenderimit, në ketë Autorizim të prodhuesit është i shënuar numri i një aktiviteti paraprak të prokurimit: **214-23-13065-211** e jo ashtu siç kërkohet me legjislacionin e prokurimit publik, që duhet të jete numri i aktivitetit të prokurimit: **214-24-9937-2-1-1.** Ofertimi me Autorizim që ka të shënuar numrin e prokurimit të një aktiviteti tjetër, automatikisht ketë Autorizim e bene ja valid dhe ofertën e bene të pa përgjegjshme.

- Bazuar ne informatat që kemi marre në takimin që kemi pasur me përfaqësuesit e EXPRESS MENU s.r.o nga Çekia me datën **11.10.2024** na është thëne së në Dhjetor të vitet 2023 EXPRESS MENU s.r.o nga Çekia i ka lëshuar një Autorizim për një kompanie nga Kosova pa e cekur emrin e kompanisë. Prandaj konsiderojmë së edhe Katalogët që ka dërguar së bashku me ofertën OE: "Isuf Musliu" B.I për aktivitetin e tanishëm me numër të prokurimit: **214-24-9937-2-1-1** janë të njëjtit sikur ata që i ka dërguar të AK me **11.03.2024** për aktivitetin paraprak me numër të prokurimit: **214-23-13065-211** edhe pse AK gjate zhvillimit të aktivitetit të tanishëm me numër prokurimit: **214-24-9937-2-1-1,** ka ndryshuar komplet specifikat teknike të artikullit: **USHQIM I PAKETUAR 3- Pashtet pule.**

Së Autoriteti Kontraktues: AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURINË PUBLIKE vlerësimin e ofertave **nuk e ka bere në harmoni** me nenin **59 dhe 72 të LPP** e ka konstatuar edhe Paneli Shqyrtues në vendimin nr. **OSHP: 2024/1208** të datës **13.02.2025**, ku ka konstatuar:

"Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 dhe 72 të LPP" .

Pretendimi ankimor 4 - shkelje e nenit 97 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik - Shkeljet e rënda - Mos Zbatimi i vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit nr. 2024/1208 i datës 13.02.2025

Autoriteti Kontraktues: AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURINË PUBLIKE gjate Ri-vlerësimit të ofertave **nuk ka zbatuar vendimin nr. 2024/1208 i datës 13.02.2025** për faktin së prape ka vazhduar me shkeljen e legjislacionit primar dhe sekondar të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, nuk ka zbatuar nenin **59 paragrafi 2 dhe nenin 72** te LPP për faktin së nuk ka kërkuar sqarime shtese as nga kompania jone Beni Dona Plast SHPK e as kompania prodhuese EXPRESS MENU s.r.o. nga Çekia por direkt na ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit.

Bazuar në të gjitha këto që i cekem me larte dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të cekura me larte, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP –së, që Ankesën tone ta konsideroje si të bazuar dhe të urdhëroje AK- Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, që të anuloj vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 19.03.2024 dhe të zbatoje Vendimin e Panelit Shqyrtues nr. nr. 2024/1208 i datës 13.02.2025.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes së Aneksit 5- Kërkesë për Informacione shtese, shpenzimet përgatitjes së Ofertës shume voluminozë duke përfshi shpenzimet e udhëtimit ne Çeki, shpenzimet përgatitjes së Kërkesës për Ri shqyrtim, shpenzimet e përgatitjes së Ankesës për OSHP dhe fitimet e pritura.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. B05- Njoftimi për kontrate: 27.09.2024
2. Aneksi 5- Kërkesë për Informacione shtese Beni Dona Plast SH.P.K: 08.10.2024
3. Procesverbali i Hapjes se Ofertave: 15.10.2024
4. Letra Standarde e Kërkesë për informata mbi tenderët me çmimeve jo normalisht të ulëta:19.11.2024
5. Përgjigjja në kërkesën e AK për çmime jo normalisht të ulëta ,Beni Dona Plast SH.P.K: 20.11.2024
6. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Anulim i aktivitetit të prokurimit: 26.03.2024
7. Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar: 27.11.2024 ora 15:37
8. Kërkese për mes Platformës së E-Prokurimit për qasje në dokumentet e tenderit: 29.11.2024 ora 10:22
9. Kërkese për mes emailit zyrtare për qasje në dokumentet e tenderit: 29.11.2024 ora 10:27
10. Konfirmim i AK për mese emalit zyrtare për lejimin e qasjes në Dokumentet e Tenderit me datën 02.12.2024 prej orës 11:00 deri 12:00 qasje: 29.11.2029 ora 14:37
11. Përsëritje e Kërkesës për mese emalit zyrtar për qasje – dërgimin e dokumenteve të nderit:29.11.2024 ora 15:18
12. Kërkese për Rishqyrtim: 02.12.2024
13. Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 05.12.2024
14. Vendimi i OSHP-së - OSHP: 2024/1208 i datës 13.02.2025
15. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Dhënie e kontratës, OE " Isuf Musliu" BI ne vlere prej 1,371,644.00 € : 19.03.2025
16. Kërkese për Rishqyrtim: 24.03.2025
17. Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 27.03.2025
18. Dëshmitë shtese
19. Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 te LPP-së;

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

COMPANY
BENI DONA *plast*
export - import

To: EXPRES MENU s.r.o, Address: Petrikovicka, 518, 541 03 Trutnov,

From: Beni Dona Plast SH.P.K, Ulpiana, Prishtina,

Subject: Request for Confirmation

Date: 01.04.2025

Greetings Mr. Sogel,

I hope this message finds you well and that your work is going smoothly.

As you are aware, on 11.10.2024, we received authorization from your company, EXPRES MENU s.r.o, to submit a bid for the procurement tender with number: **214-24-9937-2-1-1 - Food preparation and supply services for the needs of AKSP - re-tender 2.**

The Contracting Authority (CA), the Academy of Kosovo for Public Safety (AKSP), during the evaluation of the bids for **item no. 4 - Beef goulash with potatoes, min. 330g**, referred to a catalog that our company had submitted along with the offer and eliminated us from the procurement process, stating that it was determined that the packaging should be multi-layered bags sealed with a protective film according to the standard, and the shelf life of the food should be 36 months, whereas our company, Beni Dona Plast, offered packaging with non-multi-layer cardboard and a shelf life of 2 years. Hence, the reasoning for the elimination included your company's catalog for the item RINDERGULASCH. (You have attached the catalog referred to by the Contracting Authority - AKSP.)

On 24.03.2024, we sent a complaint to CA-AKSP, where we stated that if the evaluation commission or the responsible officers of the CA had any doubts regarding the packaging of these items, they could have directly contacted the manufacturing company, EXPRES MENU s.r.o. from the Czech Republic, for additional clarifications regarding the four packaged items required in the Tender File and Price Descriptions.

Since CA-AKSP did not request additional clarification from your company, we kindly ask that you confirm whether your manufacturing company, EXPRES MENU s.r.o., has the capacity to produce, package, and meet the shelf life requirements as requested by CA-AKSP for item no. 4 - Beef goulash with potatoes, min. 330g, with multi-layer packaging sealed with a protective film according to the standards, consisting of meat pieces (min. 33%), fried potatoes, onions, peppers, basil, garlic, oil, and pepper.

Please provide us with your response as soon as possible, but no later than 03.04.2025.

Respectfully,

Beni Dona Plast SH.P.K

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR BENI DONA PLAST PRISHTINË

EXPRES MENU s.r.o
Address: Petrikovicka, 518, 541 03 Trutnov
e-mail: adam@expresmenu.com
www: expresmenu.com

Confirmation

Based on your request for clarification, we confirm that our company, EXPRES MENU s.r.o., the packaged item No. 4 – Beef goulash with potatoes, min. 330g, packaged in a multi-layered bag sealed with protective foil according to standards, contains meat pieces min. (33%), potatoes, onions, peppers, basil, garlic, oil, and ground pepper, which you have offered to the Contracting Authority (CA) – the Academy of Kosovo for Public Safety (AKPS), has the capacity to produce, package, store, and with a shelf life according to the technical specifications required by CA - AKPS. We also confirm that the shelf life of this item is thanks to our patented CTP (Continuous Thermal Process) technology, which ensures that the food remains free of preservatives, colorings, and flavorings at room temperature for up to 10 years. This information is public and can be confirmed on our company website (www: expresmenu.com).
We also confirm that all the packaged products requested by CA - AKPS (No. 3, 4, 5, 6) are produced according to the technical specifications required by CA in this procurement process.
For any uncertainties that may arise for the parties involved in this procurement process, they can contact us via our official email provided above.

Date: 02.04.2025

Company representative
Adam Sogel

EXPRES MENU
EXPRES MENU, s.r.o., Petříkovická 518
541 03 Trutnov, DIČ: CZ25927078

Outlook

Confirmation Request

From BENI.DONA Ragip Mustafa <beni.dona@hotmail.com>
Date Tue 01/04/2025 09:28
To Adam Sogel - EXPRES MENU <adam@expresmenu.com>

1 attachment (444 KB)
Request for Confirmation.pdf;

Dear Mr. Sogel,

I hope this message finds you well.

Attached you will find our request for confirmation regarding the procurement activity No. 214-24-9937-2-1-1 - Food preparation and supply services for AKSP.

Best regards.

"Beni Dona Plast" SH.P.K
Kontakti
Tel.: +383 (0) 44 100 008,
Mob: +383 (0) 49 681 679
Email: prokurimi.zyra@gmail.com ose beni.dona@hotmail.com